



PA KOMUNIKIM NUK KA DEMOKRACI



DEMOKRACIA, PJESË E PANDASHME E JONA

LORENA (12), ANETË (12), ANILA (13), HABIBE (13), EDONIT (12), KORAB (12)



Barazia, respekti dhe solidariteti janë disa nga elementet, pa të cilat demokracia si sistem asesi nuk mund të funksionoj. Janë këto mendimet tona dhe më poshtë do t'iu tregojmë arsyet pse mendojmë kështu

Aneta është shoqja ime e cila ka talent dhe i pëlqen shumë arti figurativ. Për më shumë, ajo sot mori lajmin se kishte fituar vendin e parë për klasën e VII-ta në garat e shkollës për këtë lëndë. Gëzimi i saj ishte shumë i madh, por që u dyfishua kur arritëm në ambientin më të ngrohtë që kemi qenë ndonjëherë, në organizatën TOKA. Kështu të hareshëm dhe me lajme të mira e filluam punën në grupin e vogël. Pasi që përfunduam bashkëbisedimin në grup, edukatorja jonë na pyeti nëse dikush nga ne është i mirë në vizatim. Pa dyshim që e para që e ngriti dorën ishte Aneta. Por, në anën tjetër duart i ngritën edhe Edoniti, Anila dhe Korabi. Edhe Habibja dëshironte të bënte të njëjtën gjë,

por ngurronte, sepse e dinte që nuk ishte aq e mirë në art sa ishin shokët e tjerë, e sidomos Aneta. Me të përfunduar Habibja fjalën e saj, Edoniti tha që grupi ynë ka nevojë për sa më shumë bashkëpunim dhe respekt mes vete. Ashtu siç e mësuam, në demokraci të gjithë qytetarët janë të lirë të bëjnë atë që mendojnë që e bëjnë më së miri. Pas kësaj që thashë unë, Habibja mori lapsin dhe fletën dhe filloi të vizatonte. Aneta shtoi: „Nëse nuk kemi tolerancë dhe respekt ndaj njëri-tjetrit, atëherë ne nuk jemi duke e respektuar demokracinë.“ Kështu, të bashkuar dhe me plot motiv e shkruajtëm këtë artikull. Pra, demokracinë e gjejmë edhe në gjëra të vogla, në këtë rast në grupin tonë.



Në të majtë kemi paraqitur anëtarët e grupit. Buzëqeshja në fytyrat tona sot ishte në çdo moment e pranishme. Ndërsa, në anën tjetër kemi paraqitur dy qytetarë të barabartë



Në demokraci qytetarët gëzojnë shumë të drejta. Disa prej tyre janë: e drejta e votës mbi moshën 18 vjeçare, si dhe e drejta e arsimit


E kemi përmendur shumë demokracinë dhe menduam që do t'iu mbesnim borxh nëse nuk iu tregojmë se cili është kuptimi i saj. Nëse veç nuk e keni kuptuar gjatë artikullit, demokracia është sistem në të cilin të gjithë qytetarët janë të barabartë. Ajo nuk ka dikë të preferuar, por i pëlqen qytetarët, të cilët janë aktiv dhe të cilët punojnë e kujdesen shumë për të. Po ashtu edhe ata qytetarë, të cilët i respektojnë parimet e demokracisë si: tolerancën, respektin, barazinë, solidaritetin, etj. Duam të ndalemi pak tek solidariteti, pasi që edhe ne nxënësit e klasave të VII-ta jemi treguar solidarë. Disa herë ne kemi mbledhur të holla për qytetarë me sëmundje të ndryshme dhe iu kemi dalë në ndihmë atyre me mundësitë tona. Ne jemi qytetarë human dhe kujdesemi për të tjerët. Kështu zhvillohet demokracia, duke trajtuar njëri-tjetrin me kujdes e me dashuri.



Motivi që sot na përcolli gjatë Punëtorisë shpresojmë që do të na përcjellë gjatë gjithë jetës

KONTRIBUOJMË PËR VENDIN TONË

LORIK (13), ZANFINA (12), IDRIZ (12), ERION (12), NATYRË H. (12), SARA (13)



Të jesh qytetar aktiv do të thotë të punosh për të mirën e komunitetit ku bëni pjesë. Shpërblimi më i mirë i aktivizimit për vendin tënd është ndikimi për të ndryshuar vendin për të mirë

Oborri i shkollës sonë është i bukur. Ne kalojmë pushimet e gjata të orëve mësimore aty. Ndonëse ekzistojnë rrethoja në oborrin e shkollës sonë, ato kanë nevojë për përmirësime. Koha ka bërë që këto rrethoja të vjetërohen dhe t'iu largohet ngjyra. Kjo e ka zbe-




hur pak bukurinë që ka pasur shkolla jonë. Andaj, ne si nxënës mund të organizohemi dhe të ndikojmë në përmirësimin e rrethojave të shkollës. Për shembull, klasa jonë mund të mbledhë të holla, të blej ca ngjyra dhe pas orëve të mësimit t'i ngjyros ato dhe t'i bëj si të reja. Kështu, ne do të kemi një oborr më të bukur, por edhe do të jemi shembull për nxënësit e tjerë. Kjo është qytetaria aktive. Çdo iniciativë nga ana jonë për të rregulluar jetën në komunitet, na bën neve qyte-

tarë aktiv. Ne mendojmë se pjesa më e mirë e të qenurit aktiv është ndjenja që vie pasi të përfundoj puna. Ajo ndjenjë quhet krenari. Aktivizimi dhe puna për forcimin e shtetit tënd dhe të demokracisë, të bëjnë të ndihesh krenar me veten dhe të bëjnë shembull për të tjerët. E ku ka më mirë se kaq?

E përmendëm demokracinë. Ne e dijmë se kur e dëgjoni këtë emër, në mendje iu vijnë të drejtat që kemi ne si qytetarë. Këto të drejta janë: e drejta e shprehjes së lirë, ajo e votës, e drejta e shkollimit, etj. Mirëpo, mos harroni se me të drejtat vijnë edhe përgjegjësitë. Ne si qytetarë pa dyshim që kemi përgjegjësi ndaj vendit tonë. Pagesa e taksave, respektimi i ligjit, pjesëmarrja në zgjedhje, janë vetëm disa nga përgjegjësitë që ne i kemi ndaj vendit tonë. Demokracia na dhuron kaq shumë gjëra, por edhe ne duhet të punojmë në forcimin e saj. Gjithsesi, grupi ynë iu fton që edhe ju lexues të këtij artikulli të bëheni aktiv, ashtu si edhe na ka hije.



Autorët e artikullit, të cilët punuan me përkushtim





Zëri i popullit dëgjohef në demokraci



Të kujdesemi për ambientin ku jetojmë



Arijani dhe Genti janë dy shokë të klasës, të cilët po bisedojnë për demokracinë. Pasi Genti bën pyetjen, Arijani përgjigjet rreth kësaj pyetje



Ne duhet të jemi sa më aktiv si qytetarë, sepse me kontributin tonë do të kemi një jetë të lumtur dhe paqësore

LIGJET, RREGULLA QË NE DUHET T'I ZBATOJMË

LORENTINA (12), URTINA (12), NATYRË R. (12), GENT (12), ARIJAN (13), BLERAND (13), ALTINA (12)




Të dashur lexues, në artikullin e shkruar nga ne mund të mësoni më shumë për Kuvendin. Nëse jeni të interesuar të dini se cilat janë tri funksionet kryesore të Kuvendit, lexoni artikullin

Një ditë të mërkurë të muajit dhjetor, nxënësit e klasës së VII-të, të shkollës fillore „Halil Alidema“ nga Pozherani, Viti, do ta kenë mundësinë e veçantë ta vizitojnë Kuvendin e Republikës së Kosovës. Në hyrje të Kuvendit, ashtu siç na tregoi edukatorja jonë, do të na pres njëri nga zyrtarët e këtij institucioni, i cili do të na shoqërojë për vizitë tek salla kryesore. Në këtë sallë mbahen mbledhjet e deputetëve me Qeverinë, që ndryshe njihen si seanca plenare. Ne gjithashtu do të kemi rastin të ulemi në ulëset e deputetëve dhe gjatë asaj kohe, do të dëgjojmë shpjegimet e personit zyrtar. Para vizitës, ne biseduam në grup të vogël. Edukatorja filloi të na tregoj se Kuvendi është institucioni më demokratik i vendit. Pastaj, vazhdoi me shpjegimin e

tri funksioneve kryesore të këtij institucioni, të cilat janë: miratimi ose jo miratimi i ligjeve, kontrollimi i punës së Qeverisë dhe përfaqësimi i popullit. Duke pasur parasysh rëndësinë e ligjeve në jetën e secilit, ne kuptuam se Kuvendi është me të vërtetë institucion shumë i rëndësishëm, pasi që vendimet për miratimin e ligjeve merren pikërisht në Kuvend.

Rregullat e komunikacionit lehtësojnë shumë jetën tonë, sepse gjatë vozitjes së veturës apo kalimit të rrugës qytetarët ndjehen më të sigurtë. Por, kjo siguri rritet nëse qytetarët janë të përgjegjshëm dhe i respektojnë rregullat.

Kuvendi na ofron shumë gjëra të mira, mirëpo jemi ne ata të cilët gjithmonë duhet të veprojmë për të mirën e vendit. Kjo arrihet duke qenë të respektueshëm me njëri-tjetrin, duke bashkëpunuar dhe duke punuar shumë, në mënyrë që shteti ynë të ecë në një rrugë të ndriçuar.



Tri funksionet kryesore të Kuvendit



Ne jemi e ardhmja



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Halil Alidema“
Klasa: VII-3
Vendi: Pozheran, Viti